

VENDIM
Nr.550, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, zëvendësohet me lidhjen nr.1 me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

b) Në fund të pikës 5, pas fjalëve “... për këtë periudhë”, shtohen fjalët “... dhe jo më shumë se 9 mbledhje në vit...”.

c) Në pikën 9, pas fjalëve “... me kontratë ...”, shtohen fjalët “... nga kategoria “Akademik” dhe kategoria “Profesor”..., ”.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha